

Respektimi i dispozitave ligjore lidhur me formën dhe elementet e akteve administrative nga organet e administratës shtetërore

Abstrakt

Përmes këtij punimi është synuar që të sqarohet rëndësia e respektimit të dispozitave ligjore lidhur me formën dhe elementet e detyrueshme të akteve administrative nga organet e administratës shtetërore. Respektimi i formës dhe strukturës përbën detyrim ligjor dhe kushtetues, i cili është i ndërlidhur me të drejtën për një proces të drejtë dhe të paanshëm, ku zbatueshmëria e tij rrit besueshmërinë e qytetarëve mbi administratën dhe krijon siguri juridike.

Në këtë punim janë analizuar (90) vendime të organeve të administratës shtetërore dhe përmes tyre kemi vërejtur se ku qëndrojnë mangësitë në shumicën e vendimeve të analizuara. Duke analizuar çdo pjesë të aktit administrativ në mënyrë të hollësishme në rrafshin teorik, kemi paraqitur rezultatet e hulumtimit për atë pjesë, duke kombinuar pjesën teorike me pjesën praktike.

Një administratë e mirë, nxjerrë akte cilësore administrative, andaj serioziteti i organeve shtetërore në këtë drejtim është i domosdoshëm për Kosovën dhe gjithë shtetet e tjera që duan të kenë sundim të së drejtës. Aktet e mangëta apo jocilësore përveç që mund të jenë shkak i paligjshmërisë së tyre, ato lehtësisht mund të jenë bazë për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore, si dhe krijimin e mosbesimit të qytetarëve karshi organeve shtetërore.

Në këtë punim po ashtu kemi zhvilluar anketim me përpilues të akteve administrative (zyrtarë ligjorë dhe zyrtarë administrativë) lidhur me respektimin e dispozitave ligjore për formën dhe strukturën e aktit, mangësitë në akte dhe arsytet e lëshimeve që bëhen.

Ky punim mund të shërbejë si bazë për zyrtarët administrativë se çfarë do të thotë një akt cilësor administrativ, rëndësia e kualitetit dhe cilësisë së aktit, pasojat nëse nuk është i tillë, si dhe në cilat pjesë të aktit duhet të kenë kujdes të shtuar, gjatë përpilimit të tyre.

